

Nr. Prot. 105



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E FINANCAVE

KABINETI

Nr. 18237/2 Prot.

Tiranë, më 26 Janar 2016

**Drejtuar:** Z. GJERGJ EREBARA,  
Znj. Kristina VOKO, ✓  
*Perfaqësues të subjektit "BIRN Albania",  
Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Kulla S, Ap. 22, Tiranë.*

**Për dijeni:** Znj. AMARILDA XHAFERI  
*Inspektore Për të Drejtën e Informimit  
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave  
Personale  
Rruga e Kavajës, Nd. 80, H. 1, Kati 5, 1023, Tiranë*

**Subjekti:** Kthim përgjigje

I nderuar z. Erebara!

Në përgjigje të kërkesës suaj nr 18.237 prot, datë 30.12.2015 me objekt "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit", iu sqaroj si më poshtë vijon:

1. Nuk është e vërtetë që raportet fiskale mujore nuk botohen.
2. Publikimi i raporteve fiskale mujore nuk është ndërprerë dhe nuk ka një vendim për ndërprerjen e tyre. Ato gjenden lehtësisht në faqen e internetit të Ministrisë së Financave në link-un:  
<http://www.financa.gov.al/al/raportime/programimi-ekonomiko-fiskal/raporte-dhe-statistika-fiskale-mujore/statistika-fiskale-mujore>;
3. Strategjia e luftës ndaj informalitetit (SAI) është hartuar nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave. Prezantimi i kësaj strategjie është bërë në Këshillin Ekonomik Kombëtar (KEK) me përfaqësues të grupeve të biznesit.

*(Bashkëlidhur lutem gjeni një kopje të strategjisë në PPT( versionin e shkurtuar) dhe planin e veprimit që është i ndarë në 3 shtylla. Strategjinë e plotë e disponon Këshilli i Ministrave)*

Kjo strategji është për periudhën shtator – dhjetor 2015 dhe do të pasohet nga strategjia afatmesme, që është rrjedhim i analizës së rezultateve të nxjerra nga operacioni i parë.

4. Ju informojmë se kjo strategji është sqaruar dhe prezantuar në vazhdimësi nga të gjithë drejtuesit e lartë të qeverisë, duke filluar nga Kryeministri, i cili e çeli operacionin me një aktivitet ku u sqaruan pjesë të rëndësishme të strategjisë. Daljet publike të Ministrave dhe Zv / ministrave edhe në debate me gazetarë, shoqëri civile dhe shoqatat e biznesit, kanë sqaruar në detaje pjesë të strategjisë. Intervistat në median e shkuar dhe vizive, për lancimin dhe ecurinë e procesit kanë qënë periodike.

Transparenca me partnerët.

5. MF e ka vendosur në dispozicion dhe e ka prezantuar këtë strategji sipas kërkesave respektive të palëve të interesit.

Konsultimi:

6. Prezantimi i strategjisë në Këshillin Ekonomik Kombëtar, në përbërje të të cilat janë përfaqësues të biznesit, prezantim në Këshillin Tatimor, dhe takime me biznese, të kryesura nga Kryeministri, Ministrat si dhe Drejtorët e Përgjithshëm të Tatimeve dhe Doganave. Zv/Ministrja e Financave ka bërë një prezantim të gjatë dhe u është përgjigjur pyetjeve të parashtuara nga përfaqësuesit e Ambasadave Europiane në Tiranë, takim ky i zhvilluar në zyrat e Delegacionit të KE-së në Tiranë, në Shtator 2015. Ministria e Financave ka zgjedhur një bashkëpunim të afërt me gjithë palët e interesuara dhe ka qënë në dispozicion të çdo pyetjeje apo ftese të bërë nga gazetarët, bizneset, etj mbi strategjinë.
7. Paketa fiskale 2014 është hartuar nga Ministria e Financave nën sugjerimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, në kuadër të plotësimit të nevojave buxhetore. Paketa fiskale 2014 është konsultuar me Këshillin Tatimor, strukturë e ngritur pranë Ministrisë së Financave. Këshilli Tatimor është organ këshillimor, i ngritur pranë Ministrisë së Financave, në bazë të nenit 38 të ligjit nr 9920/2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar. Këshilli Tatimor është forum teknik këshillimi dhe bashkëpunimi për dhe ndërmjet Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe tatimpaguesve. Këshilli Tatimor përbëhet nga 18 (tetëmbëdhjetë) anëtarë, prej të cilëve 12 (dymbëdhjetë) janë përfaqësues të tatimpaguesve dhe 6 (gjashtë) janë përfaqësues të institucioneve publike. Diskutimi i kësaj pakete me Këshillin Tatimor është bërë në datën 17 dhjetor për arsye të përfundimit në fillim dhjetori të negociatave me FMN. Ministria e Financave ka bërë me dije opinionin se për arsye të kohës së gjatë që morën negociatat me FMN, konsultimi i Paketës Fiskale 2014 me grupet e interesit u bë në një kohë shumë të shkurtër.

*(Bashkëlidhur kopje te proceseverbalit të datës 17dhjetor 2013, në të cilën janë diskutuar draftligjet e paketës Fiskale 2014).*

8. Paketa fiskale 2015 është hartuar nga Ministria e Financave nën sugjerimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, në kuadër të plotësimit të nevojave buxhetore. Paketa fiskale 2015 është konsultuar me Këshillin Tatimor, strukturë e ngritur

pranë Ministrisë së Financave. Me email e datës 4 Gusht 2014, të gjithë anëtarëve të Këshillit Tatimor janë ftuar të bëjnë propozimet e tyre për Paketën Fiskale 2015. Në datën 5 Nëntor 2014 është zhvilluar mbledhja e këshillit Tatimor në të cilën janë ftuar anëtarët e KT për të diskutuar mbi Paketën Fiskale 2015.

*(Bashkëlidhur lutem gjeni kopje te proceseverbalit të datës 5 nëntor 2014 )*

9. Gjithashtu, Paketa Fiskale 2015 është konsultuar në Këshillin Ekonomik Kombëtar, në takime të ndryshme të titullarëve të Ministrisë me përfaqësues të biznesit për politikat të ndryshme fiskale sektoriale.

10. Treguesit fiskalë janë publikuar pas datës 20 të çdo muaji, pra përtej këtij afati indikativ, të cilin po vetë MF e ka vendosur të tillë. Duhet kuptuar që një “afat indikativ” ka për qëllimi të informojë se kur bëhet publik një tregues/statistikë/informacion i caktuar

Devijimi nga ky afat indikativ i datës 20 të çdo muaji që MF vetë ka vendosur, lidhet me arsye objektive të vonësive të procedimit të informacionit dhe veçanërisht me përditësimet e ndryshme që i janë bërë sistemit fiskal në periudha të ndryshme.

Gjithsesi, treguesit fiskalë janë bërë gjithnjë publikë brenda muajit pasardhës, kohë e cila, krahasuar me praktikën e zakonshme të vendeve të rajonit apo dhe të BE, është një kohë serisht relativisht e shpejtë e bërjes publike të këtij informacioni/statistike.

MF në mënyrë konsistente do vijojë të bëjë maksimumin e saj për të bërë publike, në një kohë sa më të shkurtër të mundshme çdo informacion relevant.


*(Bashkëlidhur gjeni Urdhrin përkatës të Ministrit të Financave)*

11. Projektbuxhetet e çdo viti buxhetor publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave. Duke filluar nga viti 2015, MF publikon edhe “Guida e Buxhetit për Qytetarët”

Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj

Me respekt,

**BARDHI SEJDARASI**



**KOORDINATOR PËR  
TË DREJTËN E INFORMIMIT**

## PROCESVERBAL

### Për minutat e mbledhjes së Këshillit Tatimor

I mbajtur sot, në datën 17.12.2013, me praninë e anëtarëve të Këshillit Tatimor të riformuar, si më poshtë:

1. Z. Bujar Bendo - përfaqësues i “Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë”
2. Z. Arjan Leskaj - përfaqësues i “Shoqata e Ndërtuesve”
3. Znj. Loreta Peci - përfaqësuese e “Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë”
4. Znj. Sabina Shytaj - përfaqësuese e “Shoqata e Investitorëve të Huaj”
5. Z. Sotiraq Dharmo - përfaqësues i “Institutit të Kontabilistëve të Miratuar”
6. Znj. Ardiana Shehi - përfaqësuese e Dhomës së Tregtisë Italiane
7. Z. Sherfi Bundo - përfaqësues i “Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve”
8. Znj. Fatbardha Bytyçi- përfaqësuese e “Dhomës Federale Austriake të Tregtisë”
9. Znj. Silvana Xhaveri- përfaqësuese e “Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë “Shqipëri-Britani e Madhe”
10. Znj. Brunilda - përfaqësuese e “Shoqatës Shqiptare të Bankave”
11. Znj. - përfaqësuese e “Dhomës Amerikane të Tregtisë”
12. Znj. Alketa Uruçi - përfaqësuese e “Dhomës së Tregtisë Francë-Shqipëri”

Të pranishëm në mbledhje ishin dhe anëtarët e Këshillit, përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si më poshtë:

1. Z. Ervin Mete -- Zv/Ministër i Financave (kryetar i Këshillit Tatimor)
2. Znj. Arjana Dyrnishi -- Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Marrëdhënieve Fiskale
3. Znj. Brisida Shehaj -- Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
4. Z. Artur Papajani -- Avokat i Tatimpaguesve
5. Znj. Giomela Gjini – Drejtor i Drejtorisë Teknike, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve
6. Znj. Mimoza Kalia – Drejtor i Njësive të Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë.

Pas fjalës hapëse të Zv/Ministrit të Financave, Z. Ervin Mete, u ra dakort që të trajtoheshin me rend projektligjet dhe ndryshimet që propozon secili prej tyre.

Me konsensus, u fillua me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, me diskutimet e përfaqësuesve të biznesit, si më poshtë:

- Përfaqësuesja e Shoqatës Shqiptare të Bankave (SHSHB)→  
*Propozimi i parë:* Në nenin 6 të projektligjit Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit”, fjalia e fundit me këtë përmbajtje “Shumat e rimarra nga këto rezerva apo provizione i shtohen fitimit të tatueshëm”, të mos shfuqizohet. Znj. Kalia, u shpreh se nuk duhet të bëhen ndryshime në këtë parashikim. Pra le të shfuqizohet kjo fjali dhe nuk përbën asnjë problem për bankat.

Znj. Gjini u shpreh se, nëse e shfuqizojmë këtë fjali, ashtu sikurse është propozuar në projektligj, mund të ketë vështiresi në praktikë pasi mund të konsiderohen si të patatueshme ngaqë ka qënë e shkruar në këtë nen të ligjit por në fakt kjo është thjesht për tu sqaruar dhe pse ngelet nuk ka asgjë të keqe përderisa ka qënë.

Z. Bundo u shpreh se fjalitë janë të plota dhe nuk duhen ndryshuar sepse lënë vend për interpretim.

*Propozimi i dytë:* Në nenin 24 të ligjit ekzistues, të parashikohet shprehimisht “borxhi i keq”, për bankat.

Z. Dharmo, u shpreh në parim se fjala “provigjone”, duhet ndryshuar kudo në ligj pasi nuk është e saktë dhe duhet zëvendësuar me fjalën “zhvlerësim”.

Znj. Uruçi, u shpreh se, nuk është i thjeshtë identifikimi i mbarimit apo ezaurimit të procedurave nga ana e përmbauesve për ekzekutimin e borxhit të keq.

Znj. Dyrmishi, u shpreh se, nuk është bërë ndryshimi i kërkuar në ligj, pasi më parë është ndryshuar në udhëzim për borxhin e keq dhe ky ka qënë propozim i vetë Bankws sw Shqipwrisw dhe SHSHB.

*Propozimi i tretë:* Me ndryshimin e nënit 25 të ligjit aktual, çfarë do bëhet me ato banka që kanë paguar penalitetet nga organet tatimore?

Lidhur me këto propozime, Zv/Ministri i kërkoj SHSHB, të sjellin propozimet me shkrim për të parë nëse do të reflektohen apo jo.

- Z. Arjan Leskaj, përfaqësues i Shoqatës së Ndërtuesve (SHN), bëri komentet e mëposhtme:

*Së pari,* kundërshtoi rritjen e tatimit mbi fitimin nga 10 në 15%, dhe së dyti, kërkoj heqjen e parashikimit pagesën e ndërtuesve edhe për pronarët e tokave (neni 20, paragrafi i tretë). Z. Dharmo, u shpreh dakort me propozimet e SHN.

- Z. Dharmo, përfaqësues i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar (IKM):

*Së pari,* rritja e tatimit mbi fitimin nga 10, në 15% nuk është zgjidhje, pasi në parim, nuk është shkalla tatimore ajo që zgjidh problematikat por është mirwadministrimi. Të bëjmë të paguajnë ata që nuk paguajnë dhe jo të ngarkojmë më shumë ata që paguajnë. Rritja e tatimit mbi fitimin mund të ulë fuqinë konkurruese të Shqipërisë krahasuar me vendet e rajonit.

*Së dyti,* rritja e shkallës tatimore mbi të ardhurat që vijnë nga paga, nuk është positive pasi edhe parimisht, nuk mund të tatóhet më shumë puna sesa kapitali. Z.Dharmo u shpreh se nuk duhet të ketë përjashtim për asnjë kategori, për rrjedhojë as ata nga 0 në 30 000 lekë.

Z. Bundo u shpreh se, sugjerimet në lidhje me këtë projektligj konsistojnë në:

→ progresiviteti duhet të ketë më shumë sesa dy shkallë

→ kufijtë e progresivitetit duhet të jenë më të buta.

- Znj. Uruçi, përfaqësuese e Dhomës së Tregtisë Francë-Shqipëri, propozoi si më poshtë:

→ Shkalla tatimore 23% mbi pagën 130 000 lekë, është shumë e lart.

→ Duhet të shfuqizohet norma 10% e biznesit të vogël, si shkallë tatimore.

→ Në nenin 22, pika 3 e ligjit aktual “Për tatimin mbi të ardhurat”, duhet të parashikohet normë lineare e amortizimi.

- Znj. Gjini, Drejtor i Drejtorisë Teknike, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, propozoi që:

→ Në nenin 16, pika 1, gërma c) dhe pika 2, duhet shfuqizuar parashikimi për tatimin mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël.

- Znj. Shytaj, përfaqësuese e Investitorëve të Huaj në Shqipëri, u shpreh:

→ A do të rritet tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga qiratë?

→ Do të ketë ndryshime të tatimit në burim?

Zv/Ministri, Z. Mete u shpreh se kjo Paketë Fiskale nuk parashikon ndryshime të tilla.

Pas përfundimit të komenteve dhe sugjerimeve në këtë projektligj, u vijua me projektligjin “**Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.** Për këtë projektligj u propozua si më poshtë vijon:

Znj. Xhaferi, përfaqësuese e Dhomës së Tregtisë dhe Idustrië Shqipëri-Britani, u shpreh:

Si do të procedohet me propozimet dhe sugjerimet e dhëna në këtë mbledhje? Do të merren parasysh të gjitha? Apo ka disa dispozita të cilat janë të pandryshueshme?

Zv Ministri, u shpreh se, masat janë komplekse dhe se shkallët tatimore janë të pandryshueshme.

Z. Dhamo, shprehu komentet në lidhje me këtë projektligj:

→ Taksa e ndërtesës së parë ka pësuar një rritje shumë të madhe dhe të paimagjinueshme

→ taksa e ndërtesës për biznesin ka pësuar një rritje të pallogaritshme

→ taksa e fjetjes në hotel. Përcaktimi i çmimit të fjetjes në hotel nga bashkitë dhe komunat është ndërhyrje në biznes. E papranueshme.

→ marrja e pullës për efekt të pagesës së tatimit e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, rrit burokracinë. Të parashikohet që kjo pullë ta japë banka, në momentin që bëhet pagesa e tatimit.

→ duhet të përcaktohet shprehja “etj”, kur flitet për taksën e ndërtesës për shërbime, tregti *etj*.

Duhet të vendoset një kategori e veçantë për taksën për Ndërtimet dhe kapononet industriale.

→ Heqja e kufirit maksimal 10% mund të rrisë sërisht taksën e biznesit të vogël. Duhet të vendoset një kufi.

Znj. Uruçi, u shpreh se:

→ tarifa e shtëpisë në bregdet është e barabartë me tarifën e hapsirës për biznes. Në nenin 5, ku flitet për “persona fizik” duhet të ndryshohet dhe të shkruhet “individ”.

→ tek parashikimi për shpenzimet e panjohura, duhet të rishikohet dhe të përshtatet me biznesin e vogël. Shembull është parashikimi i gërmës (i), të nenit 13.

- Z. Papajani, Avokat i Tatimpaguesve, shprehu komentet dhe sugjerimet si më poshtë:

→ Vendosja e shumës 25 000 lekë, tek shkalla tatimore si shumë fiske, bën një miksim shkallësh tatimore.

→ Përkufizimi i shpenzimeve të njohura, nuk është korrekt. Duhet të ndiqen parimet e kontabilitetit. Përkufizimi në udhëzim është më i saktë.

→ Njoftim-vlerësimi, sipas parashikimit, do të dalë nëse nuk parapaguhet në kohë tatimi. Do të ketë penalitete për këtë, pasi kur flasim për njoftim-vlerësim, automatikisht konsiderohet si penalizim. Z. Papajani shtroi pyetjen nëse është apo jo njoftim-vlerësimi detyrim tatimor. Znj. Kalia, u shpreh se njoftim-vlerësimi nuk është detyrim tatimor, por është akt administrativ .

Z. Papajani u shpreh se nuk duhet të ketë penalitetet. Të riformulohet fjala “njoftim-vlerësim”.

→ Në projektligj parashikohet e drejta e tatimpaguesit për tu ankuar. Duhet parashikuar ku do të ankohet tatimpaguesi?

- Znj. Shchaj, Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, u shpreh se DPT nuk mund të shërbejë si agjent, pasi me ligj DPT është organi kompetent për mbledhjen dhe administrimin e taksave dhe tatimeve.

Pas përfundimit të komenteve dhe sugjerimeve në këtë projektligj, u vijua me projektligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 28.07.1998 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar**. Për këtë projektligj u propozua si më poshtë vijon:

Z. Bundo, përfaqësues i Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve”, shtroi komentet dhe sugjerimet e tij:

→ TVSH 20% është realisht tatim i tërthortë mbi pagën për profesionet e lira, të cilave nuk i njihen shpenzime të zbritshme.

Z. Dhamo, kërkoi të dinte qëllimin apo objektivin e synuar me vënien e kësaj mase. Në lidhje me ndryshimet për heqjen e përjashtimit për operacionet hidrokarbure.

Zv. Ministri i financave, Z. Mete, u shpreh se ka pasur abuzime më këtë përjashtim dhe qëllimi është t'i fusim në system për t'i kontrolluar më mirë. Rimbursimi i TVSH për këto subjekte do të bëhet nga sistemi i Thesarit.

Z. Shyti, u shpreh se nuk do mund të bëhet rimbursimi i përmuajshëm i TVSh-së për këto kompani.

Znj. Uruçi, u shpreh se Dhoma Franceze e Tregtisë nuk ka qëndrim në lidhje me këtë çështja, por në kuadrin e një saktësimi, ajo u shpreh se, nuk ka në ligjin specifik të hidrokarbureve fazë zhvillimi, por ka periudhë zhvillimi, përfshin edhe fazën e prodhimit.

Z. Bendo, përfaqësues i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, u shpreh se, wshtw rritur afati nga 30 në 60 ditë dhe lekët kthehen nga thesari.

- subjektet duhet të paguhet pas kalimit të afatit në fjalë, kjo nëse është kontrolluar apo jo për arsye që varen nga vetë trajtimi i kërkesës prej administratës tatimore.
- si dhe kërkesa për rimbursim nga subjekti i drejtohet njëkohësisht edhe Thesarit dhe regjistrohet në sistemin e saj, kjo në respekt të afatit 60 ditë që dmth pas kësaj date subjekti ka të drejtë të kërkoj rimbursimin e menjëhershëm në Thesar.

Z. Dhamo, sugjeroi që TVSh të paguhet vetëm për faturat e paguara.

***Mbledhja u mbyll, me porosinë për të dërguar komentet dhe sugjerimet me shkrim brenda datës 18.12.2013.***



## PROCESVERBAL

### Për minutat e mbledhjes së Këshillit Tatimor

I mbajtur sot, në datën 05.11.2014, me praninë e anëtarëve të Këshillit Tatimor të riformuar, si më poshtë:

1. Z. Bujar Bendo - përfaqësues i “Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë”
2. Z. Arjan Leskaj - përfaqësues i “Shoqata e Ndërtuesve”
3. Znj. Loreta Peci - përfaqësuese e “Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë”
4. Znj. Sabina Shytaj - përfaqësuese e “Shoqata e Investitorëve të Huaj”
5. Z. Sotiraq Dhamo - përfaqësues i “Instituti të Kontabilistëve të Miratuar”
6. Znj. Ardiana Shehi - përfaqësuese e Dhomës së Tregtisë Italiane
7. Z. Sherfi Bundo - përfaqësues i “Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve”
8. Znj. Fatbardha Bytyçi- përfaqësuese e “Dhomës Federale Austriake të Tregtisë”
9. Znj. Silvana Xhaveri- përfaqësuese e “Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë “Shqipëri-Britani e Madhe”
10. Znj. Brunilda - përfaqësuese e “Shoqatës Shqiptare të Bankave”
11. Z. Lorenc Gjoni - përfaqësuese e “Dhomës Amerikane të Tregtisë”
12. Znj. Alketa Uruçi - përfaqësuese e “Dhomës së Tregtisë Francë-Shqipëri”

Të pranishëm në mbledhje ishin dhe anëtarët e Këshillit, përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si më poshtë:

1. Z. Ervin Mete -- Zv/Ministër i Financave (kryetar i Këshillit Tatimor)
2. Znj. Arjana Dyrmishi – Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Marrëdhënieve Fiskale
3. Z. Artur Papajani -- Avokat i Tatimpaguesve

Mbledhja u zhvillua për të diskutuar mbi paketën fiskale 2015. U ra dakord që diskutohet seicili ligj dhe anëtarët të shprehin komentet e tyre.

#### 1. LIGJI “PER TATIMIN MBI TE ARDHURAT”.

##### Z.Sotiraq Dhamo

1. **Propozim:** Në nenin 3 të projekt ligjit parashikohet ndryshimi i pikës 1 të nenit 13/2. Ky ndryshim parashikon që në deklaratën e të ardhurave personale do të duhet që individët për fitimin që marrin nga BV që është subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin do të deklarojnë të ardhurat nga aktiviteti I tyre si të ardhura bruto personale? Nuk përcaktohet se si do të taten ato me 7.5% apo me 10% sa të tjerat? Nuk ka një rregullim të qartë për këtë.

**Koment nga teknikët e MF:** Ky propozim ka gjetur zgjidhje në nenin 13/6 pika 3.

Tatimi i llogaritur dhe tatimi për të paguar nga zhvillimi i veprimtarisë së bizneseve që realizojnë gjatë vitit fiskal një qarkullim nga 0 deri në 8.000.000 lekë, është tatimi i paguar sipas Deklaratës së Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

Te ardhurat e krijuara nga Biznesi i Vogel do te taten vetem me 7.5%. ne Deklarate do te plotesohet si fushe e lire tatimi i paguar.

**2. Propozim:** Nuk shprehet dakort me shfuqizimin e pikave a) dhe ç). Ky ndryshim heq shpenzime te zbritshme per deklarimin personal pagesat ne fondet vullnetare te pensioneve dhe taksen e ndertesës. Ne kushtet kur deklaruesit e tatimit te ardhruave personale kerkohet qe te rritet numri I tyre, ky ndryshim eshte nje kthim prapa. Ne ligj parashikohen shume pak shpenzime te njohura per ata qe deklarojne te ardhurat personale ne kete Deklarate.

**Koment nga tekniket e MF :** Nje nga shfuqizimet ne kete pike ka qene heqja si shpenzim i zbritshme, për efekt të llogaritjes së të ardhurës së tatueshme e Kontributeve vullnetare në fondin e pensionit vullnetar dhe kontributet vullnetare. Kjo ka ardhur si pasoje e harmonizimit teligjit "Per pensionet vullnetare" me ligjin "Per tatimin mbi te ardhurat. Kontributet e bera ne fondit e pensioneve deri ne masen e percaktuar ne ligjin "per pensionet vullnetare eshte e perjashtuar nga tatimi mbi te ardhura. Ne kete kontekst nuk ben me sens njohja si shpenzim i zbritshëm.

Lidhur me taksen e pronës sqarojme se ky ka qene nje rekomandim I FMN.

**3. Propozim:** Në nenin 21 "Shpenzime të njohura", në gjermën m):

"Por mbase ka nevojë qe te percaktohet ne menyre pak me te drejtperdrejte dhe me te plote kerkesa qe te hartohen keto normative duke nxjerre edhe pergjegjesine e ministrive dhe ne bashkepunim me shoqatat e biznesit. Sepse mund te ndodhe qe Ministrite te bejne gjerat pa u konsultuar dhe keshtu ne VKM mund te mos shprehen te gjitha nevojat e biznesit per keto raste"

**Koment nga MF:** Draft VKM do te pergatite nga Ministria e Financave dhe ne procesin e draftimit do te merren ne konsiderate edhe propozimet e Keshillit tatimor.

**4. Propozim:** Për pikën 3 të neni 22 "Amortizimi", që shpenzimi i zbritshem i periudhes te njihet kur vlera e mbetur e aktivit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 20% (per softëare) dhe 15% (per ndertesë makineri), e koston historike të këtij aktiv.

#### **Znj. Fatbardha Bytyçi ( Dhoma Austriake)**

**5. Propozon:** Për pikën 3 të neni 22 "Amortizimi", që shpenzimi i zbritshem i periudhes te njihet kur vlera e mbetur e aktivit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 12 % e koston historike të këtij aktiv.

Argumenti i dhene nga dhoma është se në krahasimin me rajonin, vendi i përdorur për krahasim nga Ministria e Financave ishte Serbia, e cila zbatonte nje norme tatimi prej 15%, per te ardhurat e korporatave. Ne rast se i bejme analogji te njejtut vend lidhur me zbritshmerine e shpenzimeve dhe kryesisht njohjes se normes se amortizimit, per te njejtin grup asetesh te pershkruar ne piken 3 te nenit 22, (Sipas ligjit bashkengjitur behet fjale per Kostot e blerjes ose të ndërtimit, koston e përmirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të ndërtësave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi) atehere mund te konludojme se me ndryshimet e propozuara nga Ministria e Financave nje korporatë ne Serbi eshte ne gjendje të amortizoje për efekte fiskale te njejtin aset ne nje periudhe prej 40 vitesh, (2,5% metode lineare) ndërsa në

Shqipëri, në një periudhë prej 69 vitesh (ose e thenë ndryshe bizneseve në Shqipëri ju duhet 48% më shumë kohë për amortizimin e të njëjtit aset).

**Koment nga tekniket e MF:** Mund të pranohet propozimi i dhomës duke qenë se vjen në lehtësi të biznesit.

**Znj. Alketa Uruçi**

**6. Propozim:** Në nenin 8/1 "Të ardhura të përjashtuara" pas pikës 11, shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

"11. Kontributet vullnetare në fondin e pensionit vullnetar dhe **kontributet vullnetare të individit për jetën dhe shëndetin** të derdhur nga vet individi, sipas ligjit nr 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"

**Koment nga tekniket e MF:** Në këtë nen janë përfshirë parashikimet e ligjit nr. *ligjit nr 10197, datë 10.12.2009.*

**7. Propozim:** Në nenin 13/2, Gërma a) të riformulohet me këtë përmbajtje:

"Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët dhe të fitimin të tatueshëm nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit si i vetpunësuar (person fizik tregtar) sipas Deklaratës së Tatimit të Thjeshtuar mbi fitimin ose **Formularit të Deklarimit dhe Pageses së Tatimit mbi Fitimin, cilido qofte rasti.**"

**Argumentimi i i bere ka qene:** Një problem që është hasur në praktike është mënyra e deklarimit të të ardhurave individuale të personave të vetpunësuar të cilët kanë një qarkullim me të madh se 8 milion leke. Këta individë paguajnë tatim mbi fitimin në masën 15% mbi rezultatin e pasqyrave financiare. Për sa më sipër do të sugjerohet që dispozita e mesipërme të ndryshohet duke përcaktuar **shprehimisht se të ardhurat e realizuara si subjekt i tatimit mbi fitimin nuk deklarohen** në deklaratën individuale, **ose të ndryshohet dispozita si më lart** duke përfshirë këta lloj tatimpaguesish:

Në këtë mënyrë vendoset barazi mbi mënyrën e deklarimit të të ardhurave individuale dhe kjo deklaratë përfshin të gjitha kategoritë e individëve që krijojnë të ardhura, pavarësisht sesi janë tatuar nga pikepamja e tatimit mbi fitimin (standart apo i thjeshtuar).

**Koment nga tekniket e MF:** Duhet marrë parasysh dhe të riformulohet edhe neni 13/6 pika 3.

**Propozim:** Sugjerohet një nderhyrje me të plotë në nenin 22 "Amortimi", se pari duke aplikuar edhe për qellime tatimore **amortizimin në baze lineare**, mbajtjen individuale të të gjitha llojeve të aktiveve si dhe **shtimin e grupeve dhe normave të ndryshme të amortizimit.**

**Koment nga tekniket e MF:** Metoda lineare për shkak të kostove buxhetore nuk mund të merret parasysh në këtë moment.

## PROJEKTLIGJI “PER PROCEDURAT TATIMORE”

Znj. Alketa Uruçi

**Propozim:** Në neni 8 “Rezidenca “1/a/iii shprehja “me tepër se 183 ditë në një periudhë prej 365 ditësh” të zëvendësohet me shprehjen “më tepër se 183 ditë gjatë një viti tatimor”.

Do të sugjeronim që ndryshimi i porozuar në nenin 8 “rezidenca” të mos jete pjese e ndryshimeve dhe ky ndryshim të ndodhe në kahun tjetër, pra perkufizimi në ligjin “Per tatimin mbi të ardhurat” të ndryshoje sipas këtij ligji. Ky ndryshim do të ishte në të njëjten linjë dhe me modelin e OECD për marrëveshjet e eliminimit të dyfishtë. Përdorimi i 365 diteve apo dhe 12 muajve është një është një rregullim që po përshtatet dhe nga vende të tjera dhe mendojme se do t’i rezistonte më shumë kohës.

**Koment nga teknikët e MF:** do të merret parasysh.

**8. Propozim :** Kundërshton parashikimin se konsiderohet shkelje : *Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit persona fizikë apo juridikë tregtarë, me ose nga tatimpagues që janë në regjistrin pasiv.*

Argumenti: Një masë e tillë është një barrë e panevojshme për biznesin, barrë e cila i takon ta mbajë administrata tatimore. Detyrimi i tatimpaguesit është të paguaje tatimet që i fakojnë atij dhe jo të kontrollojë tatimpagues të tjerë. Për më tepër, me deklarin online që në datë 5 të çdo muaji administrata tatimore ka të gjithë informacionin e nevojshëm që të identifikojë të gjithë tatimpaguesit në status pasiv që kanë leshuar fature tatimore. Nëse nuk shërben ky deklarin online për një kontroll të tillë atëherë qenka teresisht i panevojshëm

**Koment nga teknikët e MF:** Nuk shprehemi dakort

**9. Propozim :** Lidhur me nenin 61/1 mendijne se detyrimi për të dhënë informacion sipas këtij neni është shumë i gjere. Duhet që ligji të përcaktojë rastet kur jepet dhe çfarë informacioni jepet.

Detyrimi i paleve të treta për të dhënë informacion nuk mund të jete i pakufizuar. Një shembull i qartë i këtij parimi është përmbajtja aktuale e neni 62.

**Koment:** Ky nen parashikon dhenien e informacionit me qëllim zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë, marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit për çështjet tatimore, të cilat janë aktualisht në fuqi. Ky ndryshim është detyrim i Republikës së Shqipërisë në cilësinë e anëtarit të “Global Forum” dhe të anagazhimeve të marra në kuadër të Konventës “Për ndihmën e Ndërsjelltë Administrative për Çështjet Tatimore”, të miratuar me ligjin nr. 146/2013, datë 06.05.2013.

**10. Propozim:** Kundërshtim i neni ku parashkruhet e drejta e kërkimit dhe rimbursimit të detyrimeve tatimore.

**Argument:** ka tatime të tjera të cilat mbarten vit pas viti duke e nxjerre gjithnjë tatimpaguesit në teprica kreditore për tatimpaguesit në fund të vitit parapaguajnë tatimin në burim me qëllim njohjen e shpenzimit si të zbritshëm pastaj aplikojnë për zbatimin e

marreveshjeve, duke e mbartur vit pas viti. Apo rasti tjetër, kur parapaguhet tatim mbi fitimin dhe shoqëritë rezultojnë prej shumë vitesh në tepricë kreditore. Është e pallogjikshme që këto detyrime të evidentuara dhe të njohura nga të dyja palët të mos rimbursohen.

**Koment nga teknikët e MF:** Nuk shprehemi dakort

**11. Propozimi:** Lidhur me nenin “Rimbursimi i TVSH dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, të specifikohet:

1. Të përcaktohet në cilin moment fillon detyrimi ligjor për kryerjen e pagesës nga thesari; pra, kur fillon afati 5 ditor; Aktualisht ka raste kur administrata tatimore ka njoftuar tatimpaguesin për shumën e aprovuar por nga ana tjetër nuk ka dërguar Urdhër Pagesën në thesar, duke sjellë një ngerc që nuk rregullohet nga ky ndryshim.

**Koment nga teknikët e MF:** Kjo nuk rregullohet në ligj por në udhëzime

2. Të specifikohet që si kontrolli ashtu edhe pagesa kryhen në total brenda afatit 60-ditor apo 30-ditor;

**Koment nga teknikët e MF:** Afatet janë të ndryshme për pagesën dhe perkontrollin pasi ato kryhen nga institucione të ndryshme

3. Të ndryshohet fjalia e fundit e paragrafit 1 duke specifikuar se “nëse nuk kryhet rimbursimi brenda afatit, pavarësisht se është bërë apo jo kontroll, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e tvsh-së së pretenduar për rimbursim”. Vetëm në këtë mënyrë do të kemi një afat rimbursimi efektiv. Përndryshe, nëse do të presim që të kryhet kontrolli, pra të miratohet shuma e TVSH dhe pastaj të fillojë e drejta e tatimpaguesit për mospagesë, vendosja e afatit 60-ditor apo 30-ditor bëhet jo-efektive dhe një rregull që anashkalohet lehtëzi nga administrata tatimore.

**Koment nga teknikët e MF:** Mund të rishikojmë formulimin

**12. Propozim:** Lidhur me nenin 104 “Fillimi i procedurave të falimentit” propozojnë heqjen e kushtit për filliminkur është në status pasiv për 3 vite.

Argument: Vetë ligji i falimentimit është lidhur hapjen e procesit me aftësinë paguese. Është e qartë që në status pasiv mund të jenë tatimpagues në pritje të rifillimit të aktivitetit por që nuk kanë probleme me aftësinë paguese. Për këto raste gjykata është e detyruar të mos cillojë procedurën (administrata tatimore do të duhet të paguajë ekspertin që do të bëjë vlerësimin e aftësisë paguese).

**Koment nga teknikët e MF:** Nuk mund ta marrim parasysh në këtë moment

## **Z.Sotiraq Dharmo**

**13. Propozim: Ne nenin 28** Të vendoset afati brenda sa ditësh nga dalja e këtyre vendimeve (vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, për çështjet tatimore.) duhet të publikohet në faqen e internetit të DPT. Kjo sepse në praktiken aktuale pavarësisht se ka detyrime të ngjashme vendimet nuk publikohen, edhe për shkak se nuk ka një afat detyrues limit publikimi.

**Koment nga tekniket e MF:** Afati nuk mund te parashikohet pasi nuk mund te parashikojme sesa mund te zgjase procedura e marrjes se vendimeve nga DPT

**14. Propozim:** Kundërshton parashikimin se konsiderohet shkelje : *Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit persona fizikë apo juridikë tregtarë, me ose nga tatimpagues që janë në regjistrin pasiv.*

**Koment nga tekniket e MF:** Nuk shprehemi dakort

**15. Propozim:** Në nenin 72, në pikën 1, gërmat “ç” dhe “d” te parashikohet publikimi i cmimeve te references dhe te dhenave te parashikuara ne keto dispozita ne faqen e [ëëë.tatimeve.gov.al](http://ëëë.tatimeve.gov.al)

**Koment nga tekniket e MF:** E diskutueshme

**16. Propozim:** Kundërshtim i nenit ku parashkruhet e drejta e kërkimit dhe rimbursimit te detyrimeve tatimore. **Argumentimi:** Eshte anti kushtetuese. Ligji parashikon parashkrimin e te dresjtes per te mos bere vleresim tatimor, por nuk i heq te drejten Administrates tatimore te kerkoje shumat e detyriemve te prapambetura ne cdo kohe.

**Koment nga tekniket e MF:** Nuk shprehemi dakort

**17. Propozim:** Ne nenin 90 kundërshtohet parashikimi “Shuma e bllokuar kalon për llogari të administratës tatimore sipas procedurës së përcaktuar me Udhëzim të Ministrit të Financave”

**Argumenti:** Ky ndryshim kerkon qe te kalojne shumat e bllokuara sipas udhezimit te MF. Kjo ne fakt perben nje kundërshtim te po ketij ligji. Sepse bllokimi i llogarive banakre eshte nje nga hapat qe ndiqen per grumbullimin me forve te detyriemve taimore. Pastaj ligji percakton qarte se kur duhet te kalojne keto shuma ne llogari te organeve tatimore. Pra ne perputhje me ligjin dhe jo udhezimin.

**Koment nga tekniket e MF:** Ka nevojë për sqarim në udhëzim

#### **Shoqata e Bankave:**

**18.** Kundërshton problematiken e penalitetve ne neni 128/1 qe propozohet per ndryshim  
Koment: Kjo dispozite eshte parashikuar ne perputhje me ligjin e ri te TVSH

**19.** Propozon shtesën e pikes 3 ne nenin 90 me kete permabjtje:

“që në Nenin 90 t shtohet Pika 3 me këtë përmbajtje:

*“3. Në rast se llogaria e tatimpaguesit rezulton me balancë negative apo zero në momentin e bllokimit, pas një periudhe 1 vjeçare të bllokimit të bërë nga Banka, kësaj të fundit i lind e drejta ta mbyllë këtë llogari duke njoftuar Autoritetin për veprimin e bërë.”*

Koment: Eshte marredhenie midis paleve nuk mund te parashikohet ne ligj

20. Propozim në Nenin lidhur me tatimin (në %) për depozitat e individëve, që ky tatim do të shtrijë efektet për kontratat e Depozitave të cilat do të lidhen midis Klientit dhe Bankës duke filluar nga data 1 Janar 2015. Kjo për të shmangur cdo ekuivok pasi kontratat e depozitave ekzistuese janë tashmë të firmosura nga Banka dhe Klienti dhe nuk mund të amendohen.

**Koment nga tekniket e MF:** Nuk merret para sysh Ligji ka parashikuar se hyn nw fuqi me 1 janar 2015. Ligji nuk mund te parashikojte dispozita qe rregullojne marredheniet midis paleve te rregulluara me kontrate ku shteti nuk eshte pale.

## Z. BUJAR BENDO

21. Me ndryshimin ne kete draft-ligje,te nenit 18 ku Drejtoria e Apelit kalon ne varesi te Ministrise se Financave ,eshte i nevojshem edhe ndryshimi ose heqja e pikes 3 te nenit 109 te ligjit.

Argumenti: Nuk mund te kete vazhdim te procedimit gjyqesor me kerkese te DRT-ve, kur nje subjektit i eshte dhene e drejta ne gjykimin administrative (pra vetem per rastet kur vendimi i Drejtorise Apelit eshte ne favor te subjektit).

**Koment nga tekniket e MF:** Vendimi thote qe nuk cenohet e drejta per nje proces te rregullt ligjor. Pasi struktura e Apelimit do te jete strukture e pavarur nga ministria e financave.

22. **Propozim:** duhet te kete efekte ne vlersimin e performances vjetore te ketyre punonjesve dhe ne fillimin e procedurave disiplinore per ta ,e percaktuar ne kete ligj ,konkretisht propozojme te shtohet ne vijim te pikes 3 paragrafi

*“Vendimet e formes se prere nga Gjykata, sipas publikimit regjistrit me pasoje rrezimin e akteve te administrates tatimore, per me shume se nje raste gjate nje viti kalendarik eshte shkak per analize te pergjegjesise dhe vendimmarrje te mases disiplinore perkatese ,sipas Kodit te procedurave administrative”*

**Koment nga tekniket e MF:** E paaplikueshme

23. Kundershtim i Perdorimi i çmimeve te references.

**Koment nga tekniket e MF:** Shprehimi dakort

**24. Neni 104, pika 1/ç**, e propozuar "Fillimi procedurave të falimentimit", nuk duhet të jetë, pasi

:

Edhe në germen "a" të këtij neni është shkruar e njëjta gjë dhe minimalisht mund të përfshihet këtu (2 vjet pas kalimit në status pasiv nga QKR.). Nderkohe që fryma e ligjit është që një subjekt pasiv mund të qëndrojë i tillë me të drejtë rifillimi të aktivitetit propozojmë që koha e qëndrimit të jetë **max 5-vite** dhe me pas procedura që ndiqet të jetë ajo e **kalimit për rikujdim** dhe jo në faliment, sepse në mendimin tonë, ka mundësi të hapësirave ligjore që të mund të realizohet një proces i tillë.

**Koment nga MF:** Nuk mund ta marrim parasysh në këtë moment

## **DHOMA AMERIKANE E TREGTISE**

**25.** Kundershtohet neni 73 e drejta e administratës tatimore ku parashkruhet e drejta e kërkimit dhe rimbursimit të detyrimeve tatimor.

**34. Propozim** për nenin 71:

a. Të përcaktohet në cilin moment fillon detyrimi ligjor për kryerjen e pagesës nga thesari; pra, kur fillon afati 5-ditor;

**Koment:** do të përcaktohet në udhëzim

b. Të specifikohet që si kontrolli ashtu dhe pagesa kryhen në total brenda afatit 60-ditor apo 30-ditor;

**Koment:** Afate janë për institucione të ndryshme, prandaj janë të nevojshme

c. Të ndryshohet fjalia e fundit e paragrafit 1 duke specifikuar se «nëse nuk kryhet rimbursimi brenda afatit, pavarësisht se është bërë apo jo kontroll, personit të tatueshëm i lindi drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e tvsh-së së pretenduar për rimbursim». Vetëm në këtë mënyrë do të kemi një afat rimbursimi efektiv.

**Koment:** Do të reflektohet

Ligji PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008 "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

**Z.Sotiraq Dhano**

**Propozim:** Nuk shprehet dakort me vendosjen e takses mbi primet e shkruar të sigurimit



Argumenti: Nese kjo takse vendoset ne kushtet kur aktualisht ekziston TVSH-ja per keto prime, atehere kjo do te kete efekt ne rritjen e kosos se sigurimeve.

**Komenti i bere nga tekniket:** me ligjin e ri te TVSH eshte perjashtuar nga TVSH furnizimi, shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimi.

Mbledhja u mbyll

PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Shtylla	Objektivat	Veprimet	Institucioni përgjegjës	Institucioni për të raportuar	Afati
1		<p>↓ Komunikimi i brendshëm (midis punonjësve në terren dhe eprorëve).</p>	<p>Vendosja e Koordinatorëve në çdo institucion të përfshirë në këtë plan veprimi.</p>	<p>DPD, DPT, Ministrinë</p>	<p>Grupi i koordinimit</p>	<p>15 Shtator</p>
			<p>Takime të drejtnesve të institucionit me stafin për prezantimin e strategjise</p>	<p>Institucionet</p>	<p>Grupi i koordinimit</p>	<p>20 Shtator</p>
3		<p>↓ Pwrgatitja e axhendes se Takimeve me biznesin , Kwshtillin Ekonomik Kombetar, per prezantimin e Strategjise se informaliteti .</p>	<p>Targetimi i grupeve të biznesit</p> <p>Përgatitja e kalendarit te takimeve, KM, Ministra. DPT dhe DPD</p>	<p>Grupi I Kordinimit</p> <p>Grupi i koordinimit</p>	<p>Interministeriali I Informalitetit</p> <p>Interministeriali I Informalitetit</p>	<p>26 Gusht</p> <p>30 gusht</p>
4		<p>↓ Ndergjegjesimi i Biznesit /konsumanorin</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kasa fiskale</li> <li>▪ Deklarimi i punonjësve</li> <li>▪ Lëshimi i kuponit tatimor</li> <li>▪ Tregimi i mallrave të akcizës</li> <li>▪ Njohja me penalitetet</li> </ul>	<p>Hartimi i spoteve publicitare sensibilizuese për biznesit/ konsumantorin</p> <p>Shpërndarja</p> <p>Hartimi i axhendes së daljeve publike/ mesazhet</p>	<p>Grupi i koordinimit</p> <p>DPT, DPD MF</p> <p>Grupi i koordinimit</p>	<p>Interministeriali I Informalitetit</p> <p>Grupi i Koordinimit</p>	<p>20 tetor</p> <p>22 shtator</p> <p>5 Shtator</p>
5		<p>↓ Komunikim elektronik/ telefonik me biznesin për çdo ndryshim ligjor / kërkesë apo pagartësi</p> <p>↓ Komunikimi me publikun:</p>	<p>afësimi i qëndrave të komunikimit me biznesin</p>	<p>DPT, DPD</p>	<p>MF</p>	<p>Ne vazhdimisi</p>
6		<p>↓ <b>Ndërgjegjësimi:</b> Pagesa e taksave-përfitim i shërbimeve publike</p> <p><b>Tërheqja e kuponit :</b> Të kthejmë çdo qytetar në inspektorin e pare tatimor tatimor.</p> <p><b>Llotaria e kuponit tatimor</b></p>	<p>Dizenjimi I Website per/ llotarine sensibilizuese te Kuponit tatimor</p> <p>Prezantimi I llotarise kuponit tatimor</p> <p>Hartimi i axhendes së daljeve publike/ Informimi I publikat pwr ecurinw e aksionit</p>	<p>Grupi i koordinimit</p> <p>MF</p> <p>Grupi i koordinimit</p>	<p>Kabineti i KM</p> <p>Grupi i koordinimit</p> <p>Kabineti i KM</p>	<p>Nentor – Dhjetor 2015</p> <p>Ne vazhdimesi</p>
				<b>Institucioni</b>	<b>Institucioni per</b>	

Nr	Shtylla	Objektivat	Veprimet	Institucioni përgjegjës	Institucioni për të raportuar	Afati	
1	TERRENI	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikimi i zonave, sektorëve, bizneseve me risk të lartë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Listimi i zonave gjeografike, sektorëve, dhe bizneseve me risk të lartë.</li> <li>Krimi i disa profileve të përbashkët të riskut</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ministria e Financave, DPT, DPD</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Interministeriali I Informalitetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>5 Shtator</li> </ul>	
2		TERRENI	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i një <i>task force</i> të përbashkët të DPT, DPD, , Krimin Ekonomik, trupa e inspektoriateve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i protokollit / marrveshjeve të shkëmbimit të informacionit,</li> <li>Axhendë kontrollesh të përbashkëta në terren/. Dhe hedhja e rezultateve të kontrollit në hartë digjitale</li> <li>Krimi i një aplikacioni smart phone të përbashkët për të denoncuar informalitetin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>DPT, DPD, Krimin Ekonomik, inspektoriatet</li> <li>DPT, DPD, MF,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>MF</li> <li>MF</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>20 Tetor</li> <li>30 Nëntor</li> </ul>
3			TERRENI	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e kapaciteteve, aftësiwe profesionale, komunikuese, bashkëvepruese administratës.</li> <li>Promovim i korrekteve dhe ndëshkim i jo korrekteve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trajnime intensive mbi operacionin për administratën tatimore dhe doganore.</li> <li>Plan Veprimi për rritjen e kapaciteteve të Akademisë.</li> <li>Axhendë takimesh me zyrtarët e administratave tatimore dhe doganore me ministrat dhe KM.</li> <li>Trajnime mbi kodin e etikës, veshjes dhe sjelljes.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>MF, Akademia</li> <li>Grupi koordinator</li> <li>DPD, DPT</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kabineti i KM</li> <li>Kabineti i KM, Ministrat.</li> <li>MF</li> </ul>

			Marja e masave per ndeshkimm të punonjësve, jo korrektiv	DPD, DPT	MF	N <sup>w</sup> vazhdimvsi
4	<p>✦ Thjeshtësimi i strukturave në të dyja administratat (DPT, DPD)</p>	<p>Paraqitja per vendimarrje e ndryshimeve ne strukturat e departamenteve operative / hetimore të DPT dhe DPD</p> <p>Raport Vlerësimi i mundësisë së shkriftjes së njësisve hetimore , DPD/DPT.</p>	DPD, DPT MF	Interministeriali I Informalitetit	Dhjetor 2015	
5	<p>✦ Ndjekja e operacionit ne terren</p>	<p>Ndarja e territorit ne zona ku operacioni do te ndiqet nga afer nga 1 Zv/ minister</p> <p>Audim ne bizneset e medha me risk te propozuara nga sistemi talmor</p>	<p>MF, DPD , DPT</p> <p>ZV/ ministra te percaktuar nga Interministeriali</p> <p>DPD, DPT, MF</p>	<p>Interministeriali I Informalitetit</p> <p>MF</p>	<p>30 shtator</p> <p>30 shtator</p>	


Nr	Shtylla	Objektivat	Veprimet	përgjegjës	të raportuar	Afati
1		<ul style="list-style-type: none"> <li>✦ Ashpërsim i masave ligjore për moszbatuesit e ligjit.</li> </ul>	<p>Ndryshimet në kodin penal</p> <p>Ndryshim i ligjit "Për procedurat tatimore në RSH"</p>	<p>MF, MD MMMP</p> <p>MF, DPT</p>	<p>Interministeriali I Informalitetit</p> <p>Interministeriali I Informalitetit</p>	<p>Dhjetor 2015</p> <p>30 Tetor</p>
2		<ul style="list-style-type: none"> <li>✦ Ashpërsim i masave ligjore.</li> <li>✦ Detyrimi për t'u trajnuar/testuar.</li> <li>✦ Penalitetet në rastet e korrupsionit të kryer nga administrata shtetërore.</li> </ul>	<p>Ndryshime ligjore ose nënligjore, ku përcaktohet gartësisht detyrimi për trajnimet / testimet e vijeshme pranë akademisë.</p> <p>Ashpërsimi i kodit penal për korrupsionin në tatumë dhe dogana,</p>	<p>MF, MD MMMP</p>	<p>Interministeriali I Informalitetit</p>	<p>Dhjetor 2015</p>
3	LEGJISLACIONI	<ul style="list-style-type: none"> <li>✦ Ndryshime ligjore për rritjen e incentivave për zbatimin e ligjit.</li> </ul>	<p>Hartimi i akteve ligjore / nënligjore, për përjashtimin nga kontrolli tatimor të kompanive të certifikuara fiskalisht nga kompanite e auditimit</p> <p>Rimbursimi i TVSH në bazë të riskut.</p> <p>Kryerjen e të gjitha kontrolleve në bazë të sistemit të riskut.</p> <p>Përcaktimi i lehtësimeve të procedurave/ tatumore dhe doganore. Letësimi i taksave të biznesit të vogël</p>	<p>MF, MZHEHTS, DPT</p> <p>DPT, MF</p> <p>MF, DPT</p> <p>MF, MZHEHTS, DPD, DPT</p>	<p>Interministeriali I Informalitetit</p> <p>MF</p> <p>Grupi Koordinator</p> <p>Grupi Koordinator</p>	<p>Dhjetor 2015</p> <p>15 Shtator 2015</p> <p>Tetor 30</p> <p>Nw vazhdimësi</p>

11 21 2024 / 1

04 10 12 17

Miratohet

Shkëlqim CAME



Rregullore e brendshme

**Për afatet e rakordimit, raportimit dhe publikimit të dhënave mbi  
treguesit fiskalë të konsoliduar të Qeverisë**

**Pasqyra e lëndës:**

1. Palët e përfshira në rakordimin, raportimin dhe konfirmimin e publikimit të dhënave.
2. Afatet e rakordimit, raportimit dhe publikimit të dhënave.
3. Konfirmimi i të dhënave nga njësitë gjithëpërfshirëse.
4. Aneksa:
  - Figura 1. Fazat e përgatitjes të dhënave.
  - Tabela 1. Afatet e rakordimit ndërmjet palëve në përgatitjen e të dhënave.
  - Tabela 2. Formatit i raportimit të dhënave.

**Hyrje**

Në kuadër të bashkëpunimit me palët e përfshira në përpilimin dhe publikimin e të dhënave bazuar në legjislacionin në fuqi, ju paraqesim më poshtë rregulloren e brendshme që parashtron afatet e rakordimit mes njësiteve gjithëpërfshirëse dhe që përfundon me publikimin e të dhënave të treguesve fiskalë të konsoliduar të Qeverisë mbi baza mujore/vjetore dhe në mënyrë progresive.

**1. Palët e përfshira në rakordimin, raportimin dhe konfirmimin e publikimit të dhënave.**

Palët e përfshira janë si më poshtë:


- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Financiare
- Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të Shtetit
- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Fiskale dhe të Ardhurave Publike
- Drejtoria e Përgjithshme e Tuarimeve
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
- Degët e Thesarit në rrethe
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)
- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)
- Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP)
- Banka e Shqipërisë
- Bankat e Nivelit të Dytë
- Degët e Bankës në rrethe

*[Handwritten signature]*

## 2. Afatet e rakordimit, raportimit dhe publikimit të dhënave.

Në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit", afatet e raportimit të dhënave janë si më poshtë:

1. Struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër çdo ditë gjeneron nga sistemi informatik financiar i qeverisë (SIFQ) të dhënat e treguesve fiskalë të konsoliduar të njësisve shpenzuese dhe arkëtuese të qeverisjes qendrore dhe vendore që i kryejnë transaksionet e zbatimit të buxhetit nëpërmjet degëve të Thesarit apo që kanë akses të drejtpërdrejt në SIFQ. Të dhënat ditore i dërgohet për informim eprorëve për analiza të zbatimit të buxhetit.
2. Struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër duke filluar nga data 3 e çdo muaji dërgon tek eprorët të dhënat sipas Tabelës 1 "Afatet e rakordimit ndërmjet palëve në përgatitjen e të dhënave" (bashkëlidhur).
3. Struktura përgjegjëse e Thesarit në degë dhe e bankave të nivelit të dytë në degë brenda datës 3 të muajit pasardhës të muajit raportues rakordojnë mblidhës tyre për gjendjen sipas llogarive të ardhurave.
4. Struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër brenda datës 8 të çdo muaji, gjeneron dhe kontrollon "Raportin e rakordimit mujor sipas bankave" nga SIFQ, të cilin ua dërgon për konfirmim strukturave përgjegjëse të bankave të nivelit të dytë në qendër.  
Struktura përgjegjëse e bankave të nivelit të dytë në qendër është e detyruar mbi bazën e marrëveshjes dypalëshe me Ministrinë e Financave të konfirmojë ose të paraqesë vërejtjet e saj në strukturën përgjegjëse të Thesarit në qendër në datën 9 të çdo muaji.  
Mbi bazën e kësaj informacioni, në datën 10 të çdo muaji strukturat përgjegjëse të Thesarit në qendër dërgojnë akt-rakordinin e të ardhurave si dhe të transaksioneve të hyrjeve/daljeve nënnga Llogaria e Unifikuar e Thesarit për konfirmim në strukturat përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë, të cilat konfirmojnë deri në datën 11 të çdo muaji.
5. Strukturat përgjegjëse të Tatimeve dhe Doganave në degë dërgojnë brenda datës 4 të muajit pasardhës në strukturën përkatëse përgjegjëse të Thesarit në degë raportin perfundimtar mbi shumat progresive dhe mujore të ardhurave tatimore dhe doganore sipas strukturës së miratuar me ligj dhe formatit standard.
6. Struktura përgjegjëse e Thesarit në degë, në bazë të regjistrimeve të bëra gjatë muajit si dhe raporteve të strukturës përkatëse përgjegjëse të Tatimeve dhe Doganave në degë, rakordojnë raportin mujor të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore sipas formatit të miratuar dhe konfirmojnë në strukturën përgjegjëse të Thesarit në qendër deri në datën 7 të muajit pasardhës.
7. Strukturat përgjegjëse të ISSH, PSDKSH dhe AKKP konfirmojnë raportimin mujor në strukturën përgjegjëse të Thesarit në qendër brenda datës 5 të muajit pasardhës. Gjithashtu, raporti dërgohet i protokolluar për gjurmë auditi.
8. Struktura përgjegjëse e Bërxhit në qendër është e detyruar të rakordojë me strukturën përgjegjëse të Thesarit në qendër për të gjitha transaksionet e kryera në emër të saj nga në Llogarinë e Unifikuar të Thesarit deri në datën 5 të çdo muaji.
9. Njësitë e zbatimit të projekteve (PIU) brenda datës 5 të çdo muaji raportojnë transaksionet e financimeve të huaja në strukturën përgjegjëse të Thesarit në qendër.

 Përu 24

10. Struktura përgjegjëse e procesimit të biznesit, nëse gjatë procesit të rakordimit janë konstatuar problematika në SIFQ, ndërhyjnë për zgjidhjen e tyre. Mbas zgjidhjes së problematikave, ia komunikojnë ato strukturës përgjegjëse të Thesarit në qendër për të procesuar me tej me raportimin e të dhënave.  
Në rast se zgjidhja e problematikave ndikon në mosrespektimin e afatëve të përcaktuara për raportim, atëherë struktura përgjegjëse e procesimit të biznesit nëpërmjet SIFQ njofton eprorët për këtë situatë dhe raportimi i të dhënave të treguesve fiskalë të konsoliduar publikohet me shënime shpjeguese për përdoruesit e të dhënave.
11. Struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër, në bazë të informacionit të dërguar nga instancat e mësipërme konsolidon raportin e treguesve faktik fiskalë të Qeverisë brenda datës 12 të muajit pasardhës të muajit raportues.
12. Struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër, në bazë të dhënave përkatëse të marra nga struktura përgjegjëse e Buxhetit në qendër, përpilon raportin e treguesve fiskalë të konsoliduar të muajit raportues sipas buxhetit të konsoliduar brenda datave 12-14 të muajit pasardhës.
13. Drejtori i Përgjithshëm i strukturës përgjegjëse për Thesarin brenda asaj dite punë dërgon të dhënat e treguesve fiskalë të konsoliduar në strukturën përgjegjëse të Buxhetit dhe të Politikave Fiskale dhe të Ardhurave Publike në qendër për kontrollin përfundimtar të planit të përditësuar të buxhetit dhe për treguesit e buxhit në strukturën përgjegjëse të Buxhetit në qendër. Nëse brenda 24 orëve nuk ka vërejtje për mospërputhje të dhënash, treguesit fiskalë do të konsiderohen të mirëqenë dhe struktura përgjegjëse e IT-së brenda asaj dite punë do të bëjë publikimin në faqen zyrtare të internetit.
14. Publikimi fillestar do të bëhet me statusin "të dhëna paraprake", status, i cili do të zgjasë deri më datën 30 të po atij muaji. Pas kësaj date të dhënat duhet të marrin formën përfundimtare, duke ju hequr shprehja "paraprake", përveç rasteve kur problematikat e shfaqura nuk janë zgjidhur ende (sipas pikës 10 më sipër).
15. Të dhënat vjetore përcaktohen me udhëzim të vçantë të Ministrit të Financave.

### 3. Konfirmimi i të dhënave nga njësitë gjithëpërfshirëse

Të dhënat e treguesve fiskalë të konsoliduar të qeverisë që konfirmohen nga njësitë gjithëpërfshirëse janë si më poshtë:

- a) Sektori i Llogarisë Unike të Thesarit konfirmon në rrugë elektronike të dhënat e treguesve fiskalë të konsoliduar pasi dërgohen nga Sektori i Raportimit Financiar për:
  - o **Financimin e huaj** (zërat e të dhënave janë: të ardhura nga ndihmat, shpenzime nga financimi i huaj, hua afatgjatë (e marrë) nga e cila nën hua/mbështetje buxhetore si dhe ndryshimi i gjendjes së arkës (PII)).
  - o **Llogarinë e Unifikuar të Thesarit** (zërat e të dhënave janë: interesat e brendshme dhe të huaja, ri-paguesat, huamarrjet e brendshme (nacionale) që kuadrohen paraprakisht me borxhin, të ardhurat nga privatizimi, ndryshesat e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit "Depozitë e Qeverisë" në Bankën e Shqipërisë, transfertat për llogaritë speciale të ISSH/FSDKSH/





AKKP/Shpronësimeve, flukset mujore hyrëse/dalëse të llogarive të veçanta, "Varianca accrual-cash". mjetet në ruajtje.

Konstaton nëse "Ndryshesa e depozitës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" në bankat e nivelit të dytë konfirmuar nga struktura përgjegjëse e tyre rakordon me raportimin e përpiluar nga ISSH/FSDKSH; konstaton nëse zëri "Detyrimet ndaj ISSH/FSDKSH" është i njëjtë me diferencën midis transfertave (nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit në llogarinë speciale të ISSH/FSDKSH) dhe të ardhurave nga kontributet e arkëtuara nga administrata tatimore (konfirmuar nga Sektori i Raportimit Financiar) dhe për zërin: "Cash in transit" i konfirmon Sektorit të Raportimit Financiar totalin e Swift-it të dërguar nga bankat e nivelit të dytë në ditën e parë të muajit pasardhës.

b) **Sektori i Raportimit Financiar** konfirmon të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet pas monitorimit të strukturave përgjegjëse të Thesarit në degë deri në datën 7 të muajit pasardhës; rakordon të ardhurat buxhetore me strukturën përgjegjëse të Thesarit në degë dhe me strukturën përgjegjëse të bankave të nivelit të dytë në qendër deri më datën 8 të muajit pasardhës.

Në zërat e të dhënave mbi financimin e deficitit konfirmon: huamarrjen e brendshme (vendore), të ardhurat nga privarizimi pas konfirmimit nga Sektori i Llogarisë Unike të Thesarit, mjetet në ruajtje, llogaritë në pritje-të ardhura doganore për t'u marrë, "Varianca accrual-cash", agjent shërbimesh-llogaria kontabël 448.

Konstaton nëse ka diferencë tek zëri "Të tjera (detyrime të përkohshme)" duke shtuar shënimet shpjeguese në raportimin për publikim, të cilat përmbajnë problematikat e relatuara nga struktura përgjegjëse e procesimit të biznesit.

e) **Struktura përgjegjëse e Doganave në qendër** konfirmon të dhënat për të ardhurat e arkëtuara nga doganat (publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave), në rrugë elektronike dhe me shkresë të protokolluar, brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas afateve të rakordimit mujor.

d) **Struktura përgjegjëse e Tatimeve në qendër** konfirmon të dhënat për të ardhurat e arkëtuara nga tatimet (publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave), në rrugë elektronike dhe me shkresë të protokolluar, brenda datës 10 të muajit pasardhës, sipas afateve të rakordimit mujor.

e) **Drejtoritë ISSH dhe FSDKSH** konfirmojnë të dhënat mbi të hyrat, transfertat, të dalat dhe gjendjet e llogarive bankare në rrugë elektronike dhe me shkresë të protokolluar, brenda datës 20 të muajit pasardhës, sipas afateve të rakordimit mujor.

d) **Struktura përgjegjëse e Buxhetit në qendër**, në fillim të vitit dërgon planin e detajuar mujor dhe progresiv për zërat e treguesve fiskalë të konsoliduar në bazë të regjistrimeve të planit vjetor të detajuar në SIFQ. Gjatë vitit dërgon planin periodik me ndryshime nëse ka nga përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, rishikimi i buxhetit apo akte të tjera ligjore dhe nënligjore, i cili krahasohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër me të dhënat e raportit të gjeneruar nga

SIFQ të planit mujor dhe progresiv të treguesve fiskalë të konsoliduar. Në rast diferencash struktura përgjegjëse e Buxhetit në qendër ridërgon planin e rishikuar.

g) **Struktura përgjegjëse e Borxhit në qendër** rakordon me Sektorin e Llogarisë Unike të Thesarit për të gjitha transaksionet në emër të saj në Llogarinë Unike të Thesarit deri në datën 5 të çdo muaji dhe konfirmon brenda datës 10 të çdo muaji të dhënat përkatëse të treguesve fiskalë të konsoliduar.

h) **Struktura përgjegjëse në qendër për Politikën Fiskale dhe të Ardhurat Publike** konfirmon të dhënat e detajuara të Tatimeve dhe Doganave mbi treguesit fiskalë të konsoliduar (sipas Tabelës 2 bashkëlidhur) pas rakordimit me strukturat përgjegjëse të statistikave të tyre.

i) Për zërin: “**Detyrimet e prapambetura**”, struktura përgjegjëse e Buxhetit konfirmon të dhënat për detyrimet e prapambetura të infrastrukturës, detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera brenda datës 7 të muajit pasardhës të raportimit, me qëllim që të bëhen ndryshimet ndërmjet zërave për këto të dhëna në treguesit fiskalë të konsoliduar.

A series of handwritten signatures and initials in black ink, including a large signature on the left, several smaller initials in the middle, and a signature on the right with the number '5' written above it.